

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI B

E martë, 1 qershor 2010

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi natyror

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	9c	10a	10b	11a
Pikët														
Kërkesa	11b	11c	12a	12b	12c	12d	13	14	15	16	17	18	19	20
Pikët														
Kërkesa	21a	21b	22	23a	23b	24a	24b	25a	25b					
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**MIGJENI****Recital' i malsorit**

O, si nuk kam një grusht të fortë
t'i bij mu në zemër malit që s'bëzanë,
ta dij edhe ai se ç' domethanë i dobët -
n'agoni të përdihet si vigan i vramë.

Unë - lugat si hij e trazueme,
trashigimtar i vujtjes dhe i durimit,
endem mbi bark të malit me ujën e zgjueme
dhe me klithma të pakënaquna t'instinktit.

Mali hesht. Edhe pse përditë
mbi lëkurë të tij, në lojë varrimtare,
kërkoj me gjetë një kafshatë ma të mirë...
Por më rren shaka, shpresa gënjeshtare.

Mali hesht – dhe në heshtje qesh.
E unë vuj – dhe në vujtje vdes.
Po unë, kur? heu! kur kam për t'u qesh?
Apo ndoshta duhet ma parë të vdes?

O, si nuk kam një grusht të fuqishëm!
Malit, që hesht, mu në zemër me ia njesh!
Ta shof si dridhet nga grusht' i paligjshëm...
E unë të kënaqem, të kënaqem tu' u qesh.

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni alternativën e saktë.

1. Migjeni kapërceu traditën e poezisë shqipe duke sjellë risi në: **1 pikë**
- A) përdorimin e vargut modern
 B) krijimin e neologjizmave
 C) historizimin e situatave reale
 D) përdorimin e ligjërimit bisedor
2. Thirrja në vargun: *O si nuk kam një grusht...* është një përpjekje: **1 pikë**
- A) për të dalë nga trashëgimia e vuajtjes dhe e durimit
 B) për të ruajtur gjendjen emocionale të heroit
 C) për ta shmangur vetëm një moment këtë ndjenjë
 D) për të risjellë vetëm një gjendje të së kaluarës
3. Njeriu si qenie ekzistenciale në krijimtarinë e Migjenit: **1 pikë**
- A) zbulon raportin e tij me shoqërinë
 B) fsheh raportin e tij me shoqërinë
 C) pajtohet me shoqërinë
 D) analizon raportin e tij me shoqërinë
4. Kontrastet në fillim të strofës së katërt ndërtohen me: **1 pikë**
- A) emra
 B) folje
 C) mbiemra
 D) ndajfolje
5. Veçori e stilit të Migjenit në këtë poezi është: **1 pikë**
- A) pasqyrimi i idesë përmes forcës dialoguese
 B) pasqyrimi i idesë përmes forcës së monologut
 C) pasqyrimi i idesë përmes veprimit dhe ngjarjes
 D) pasqyrimi i idesë përmes analizës së detajeve
6. Vargu: *E unë të kënaqem, të kënaqem tu' u qeshë,* kumton: **1 pikë**
- A) inferioritetin ndaj kundërshtarit të tij
 B) kënaqësinë reale për fitoren
 C) pamundësinë e ngadhënjimit
 D) rikthimin përsëri të dëshira fillestare
7. Identifikoni të paktën dy trajta dialektore të gegërishtes në strofën e dytë dhe shkruani në krah të tyre variantin sipas normës letrare të shqipes. **2 pikë**
- a) _____
- b) _____

8. Çfarë e bashkon poetin me malësin? **1 pikë**

9. Ç'pjesë e ligjëratës është fjala e nënvizuar, në grupin emëror: *shpresa gënjeshtare*?
Si është formuar ajo? Shpjegoni ngjyresën stilistike që përftohet nga ky epitet metaforik?

a) pjesa e ligjëratës: _____ **1 pikë**

b) formimi: _____ **1 pikë**

c) shpjegimi i ngjyresës që përftohet: _____ **2 pikë**

10. Jepni një tipar njerëzor që poeti ia vesh malit. Me ç'qëllim e përdor autori këtë mjet stilistik?

a) tipari: _____ **1 pikë**

b) qëllimi i mjetit stilistik _____ **2 pikë**

11. Cila është figura e intonacionit poetik e përsëritur në strofën e parë dhe në strofën e fundit në këtë poezi? Veçoni shembullin, duke dhënë edhe gjendjen emocionale të heroit me të cilën është e lidhur kjo figurë.

a) lloji i figurës: _____ **1 pikë**

b) shembulli: _____ **1 pikë**

c) gjendja emocionale e heroit: _____ **1 pikë**

PJESA II**BALZAK****Evgjeni Grande** (*fragment*)

Të ulëriturat nga ngashërimet midis atyre mureve përhapnin një jehonë të llahtarshme. Të tri gratë, të prekura, po qanin. Lotët janë po aq ngjitëse sa edhe të qeshurat. Karli, pa dëgjuar më fjalët e të ungjit, u lëshua me vrap nëpër oborr, ngjiti shkallët, hyri në dhomë, u plas në shtrat ashtu siç ishte për të shfryrë dufin, vetëm, pa njeri pranë.

- Le të presim sa të kalojë rrëpira e parë, - tha Grandeja, ndërsa po hynte në sallë.

Evgjenia dhe e ëma shpejt e shpejt zunë vendet e tyre, dhe, pasi fshinë lotët, nisën të bënin punëdore me gishtat që u dridheshin. Dhe plaku vazhdoi:

- Këtë djalosh s'e ke për gjë; këtij i ardhka më shumë keq për të vdekurit, sesa për veten e tij, që mbeti me gisht në gojë.

- Evgjenia u drodh e tëra, kur dëgjoi këto fjalë të të atit mbi dhimbjen më të shenjtë që ka njeriu. Dhe qysh nga ky çast filloi të mendonte se me ç' baba kishte të bënte.

- Nga larg dëgjoheshin si të mbytura të qarat e djalit; dhe ngashërimi i thellë, që dukej se dilte nga fundi i dheut, mbaroi vetëm në mbrëmje dhe ca nga ca.

- I mjeri djalë!- psherëtiu zonja Grande.

Britmë fatkeqe. Xha Grandeja shikoi me radhë të shoqen, Evgjeninë dhe kutinë e sheqerit. I ra ndërmend dreka e jashtëzakonshme, që iu shtrua Karlit dhe me gjakftohtësinë e tij të ngahershme, qëndroi në mes të dhomës duke thënë:

- Hë! Jemi që jemi: unë besoj se ju nuk do të vazhdoni me xhymertllëket tuaja, zonja Grande. Unë nuk të jap të hollat e mia, që të sheqerosësh atë mistrec.

- Nëna s'ka asnjë faj, asnjë faj!-tha Evgjenia-unë...

- Po ti mos pandeh se u bërë madhore tashti,- iu kthye Grandeja së bijës, duke ia prerë fjalën,- dhe ke të drejtë të vesh kundër urdhrave të mia?

- Ati im, në shtëpinë tënde, tët nipi s' duhej t'i mungonte asgjë.

- Ja-ja-ja-ja!- këto katër rrokje, ish-vozaxhiu i shqiptoi në katër nota muzikore të ndryshme dhe pastaj shtoi:

- Im nip këtej, im nip andej, çdo gjë për tim nip! Kurse i ati e ka lënë kripë, ai ka dhënë falimenton dhe, kur ky bukurosh do t'i derdhë të gjithë lotët që ka në zemër, do ta thyejë qafën këtej. S'ia kemi ngenë që të na përmbysë shtëpinë.

- Ç' do të thotë të japësh falimenton?- pyeti Evgjenia.

- Të japësh falimenton,- ia ktheu i ati, është çnderimi më i madh midis gjithë çnderimeve të tjera.

Për pyetjet nga 13 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.

- 13.** Krijimtaria e Balzakut shënon fillimin e letërsisë realiste, sepse ajo u mbështet: **1 pikë**
- A) tërësisht në aktualitet
 - B) në historinë franceze
 - C) në mitologjinë greke
 - D) në letërsinë romantike
- 14.** Tema e zgjedhur nga Balzaku në këtë roman ka në qendër: **1 pikë**
- A) gjyqin, vetëgjyqësinë, ndëshkimin
 - B) luftën, konfliktin, paqen
 - C) politikën, kompromisin, drejtësinë
 - D) vesin, dashurinë, virtytin
- 15.** Vepra e plotë e Balzakut u përmbledh në titullin: **1 pikë**
- A) Jetët paralele
 - B) Komedia hyjnore
 - C) Komedia njerëzore
 - D) Pasqyrë e jetës njerëzore
- 16.** Personazhet e Balzakut në këtë roman shfaqen si individë: **1 pikë**
- A) që karakterizohen nga monotonia
 - B) që veprojnë në situata të jashtëzakonshme
 - C) në lëvizje dhe dinamikë të përhershme
 - D) të ngurtësuar ndaj një modeli të vetëm në jetë
- 17.** Kur Grande e quan Karlin: *ky bukurosh* përftohet figura e: **1 pikë**
- A) alegorisë
 - B) epitetit
 - C) ironisë
 - D) metaforës
- 18.** Evgjenia u drodh nga fjalët e të atit, sepse: **1 pikë**
- A) ndeshi vështrimin e nënës së saj të qetë
 - B) nuk kuptonte se çfarë donte të thoshte i ati me atë reagim
 - C) nuk kishte njohuri të sakta se çfarë i kishte ndodhur kushëririt
 - D) humbjen e njeriut të dashur e konsideronte si dhimbjen më të madhe
- 19.** Rendi i përmbysur sintaksor në togfjalëshin: *I mjeri djalë*, përdoret me qëllim që të theksohet: **1 pikë**
- A) gjendja reale, delikate e djalit pas vdekjes së të atit
 - B) ideja që paratë janë më të rëndësishmet për njeriun
 - C) keqardhja për ndarjen nga Evgjenia
 - D) reagimi i personazhit në një ambjent të huaj

20. Si e kuptoni shprehjen: *S'ia kemi ngenë që të na përmbysë shtëpinë?* **2 pikë**
Zbuloni një tipar të natyrës së Grandesë që del këtu.

a) _____

b) _____

21. Evgjenia i thotë të atit se fajin për darkën e kishte ajo:

- *Nëna s'ka asnjë faj, asnjë faj!-tha Evgjenia-unë...*

a) Ç'shenjë pikësimi ka përdorur autori në fund të fjalisë? **1 pikë**

b) Ç'nënkuptoni me të? **2 pikë**

22. Tregoni si reagon Karli në paragrafin e parë, nga fjalët e të ungjit. **1 pikë**

23. Gjeni të paktën dy fjalë të përafërta nga kuptimi me fjalën *para*, që i përkasin fjalorit të Grandesë. Njërën prej tyre përdoreni në një fjalë të urtë.

a) fjala 1: _____ **2 pikë**

fjala 2: _____

b) fjala e urtë: _____ **1 pikë**

24.

a) Në këtë fragment, pjesëtarët e familjes Grande ndodhen përballë *parasë*, e cila përbën boshtin e gjithë veprës. Përcaktoni pasojat shpirtërore që sjell kjo përballje në dy nga personazhet e këtij fragmenti.

2 pikë

b) Interpretoni si ndikon paraja në zgjidhjen përfundimtare që Balzaku i jep romanit. **2 pikë**

25. Balzaku është mjeshtër i kalimit të situatës dramatike në pikë kulmore.

Identifikoni këto dy momente në këtë fragment dhe jepni shpjegimin tuaj se si ndodh ky kalim.

a) situata dramatike dhe pika kulmore: _____ **2 pikë**

b) shpjegimi juaj: _____ **1 pikë**
